



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 93, Datë 06.04.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË GERTI SH.P.K., PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË ERE-S PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“VARDARI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, nenit 53, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/5 prot., datë 01.04.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 10, datë 20.01.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në Përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
- Në mbledhjen e bordit të datës 22.02.2021 u relatua Relacioni nr. 30/3, datë 16.02.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW.”
- Nga ana e bordit të ERE-s u konstatua nevoja e kërkimit të informacionit në lidhje me përthithjen e të drejtave të shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., nga “Gerti” sh.p.k., në vijim të “Amendim Kontrate” nr. 1818 Rep dhe nr. 388/2 Kol., datë 24.12.2020, “Për Kontratën e ndërtimit, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 MW, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”, me anë të së cilës të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., i janë transferuar shoqërisë “GERTI” sh.p.k.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 58, datë 22.02.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për dokumentimin nga aplikuesi në lidhje me sa konstatuar më lart.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE i është drejtuar shoqërisë “GERTI” sh.p.k., me shkresën nr. 405 prot., datë 02.03.2021, me anë të së cilës i kërkoi depozitim e: Dokumentacionit që vërteton kryerjen e transferimit të Lejes së Ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.; Dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të Lejes Mjedisore, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.; Kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe Bashkisë Librazhd “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, Ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar; “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe OSHEE sh.a., me palën e zëvendësuar, Dokumentacionin që vërteton transferimin e asetëve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 MW.
- Duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk kishte asnjë përgjigje, ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 405/1 prot., datë 24.03.2021, duke i kujtuar edhe njëherë detyrimin për të përcjellë në ERE sa më sipër.
- Ndërkohë përpara përfundimit të afatit të caktuar nga bordi me vendimin nr. 58/2021, shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/2 prot., datë 30.03.2021, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s për paraqitjen e dokumentacionit të lëshuar nga institucionet përkatëse, pasi nuk janë siguruar ende (varen nga vendimet e institucioneve respektive), edhe pse kjo e fundit ka aplikuar në kohë për ndryshimin e emrit të subjektit sipas kërkesave dhe sipas saj kjo e drejtë sigurohet nga kontrata e transferimit të të drejtave me MIE-n.
- Kërkesa e “GERTI” sh.p.k., rezulton e depozituar brënda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Ndodhur në të tilla rrethana, kur shoqëria jo për fajin e saj nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin e kërkuar, vlerësojmë/sugjerojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s në mënyre që ti jepet shoqërisë “GERTI” sh.p.k., mundësia për tu pajisur me këto dokumente dhe ti depozitojë ato në ERE.

Për gjithë sa me sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 60 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria GERTI sh.p.k të paraqesë brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi:
 - a. Dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të Lejes së Ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.;
 - b. Dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimet të Lejes Mjedisorë, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.;
 - c. Kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe Bashkisë Librazhd “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, Ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar;
 - d. “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe OSHEE sh.a. me palën e zëvendësuar;
 - e. Dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 MW.
3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI